



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit  
Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister  
Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office

REFERENCË:	§322314-2-2022
DATË:	30.09.2022
PËR/ZA/TO:	Klit Shala, zv. Drejtor i Departamentit Ligjor / Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
CC:	Enis Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm / Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arben Krasniqi, zv. Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore / Zyra e Kryeministrit
NGA/OD/FROM:	Labinote Kashtanjeva, Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së/ Divizioni për të Drejtën e BE-së / Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shkresa përcjellëse për Opinion Ligjor të Përputhshmërisë me <i>acquis</i> të BE-së për <i>Projektligjin për Mbështetjen e Punëve Publike</i>

I nderuari z. Shala,

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenin 12 të Rregullores Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyren e Kryeministrit, ju përcjellim Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për *Projektligjin për Mbështetjen e Punëve Publike*.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije	
Ministry of Finance	
Arkiva - Arkiva - Archive	
Nr. i Org. Org. Unit	010/400
Nr. Prot. Prot. No.	2184/2022
Nr. i faqeve No. pages	2
Data Date	30.09.2022
PRISHTINE/A	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
Zyra e Kryeministrit  
Kancelaria e Premijera - Office of the Prime Minister  
Zyra Ligjore - Pravna Kancelaria - Legal Office

OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

30.09.2022

Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me datë 30 shtator 2022, bazuar në Nenin 7, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Nenit 13 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafin 3 dhe paragrafin 4 nën paragrafin 4.19 të Rregullores Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.04/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ka dorëzuar për shqyrtim në Divizionin e të Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit *Projektligjin për Mbështetjen e Punëve Publike*.<sup>1</sup>

1. SUBJEKTI

Opinion ligjor për përputhshmërinë e *Projektligjit për Mbështetjen e Punëve Publike*<sup>2</sup> me *acquis* të BE-së.

2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e MFPT për opinion ligjor të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, janë dërguar këto dokumente:

- Drafti përfundimtar i *Projektligjit për Mbështetjen e Punëve Publike* (shqip, sërbisht, anglisht);
- Deklarata e Përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës me *acquis* të BE-së (shqip, sërbisht, anglisht);
- Memorandumi shpjegues (shqip, sërbisht, anglisht)

3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 3 nënparagrafi 1.3, Nenit 13 paragrafi 6, Neni 21 paragrafi 4 të

<sup>1</sup> Kërkesa për Opinion të Përputhshmërisë është pranuar përmes arkivës në formë fizike dhe elektronike me datën 30.09.2022. Pasi që kërkesa është kërkuar të trajtohet me urgjencë, nuk mbajmë përgjegjësi për ndonjë lëshim eventual.

<sup>2</sup> Emri i *Projektligjit* është transkriptuar sipas versionit fizik të pranuar nga MFPT, me nr. të arkivës 2314

Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Divizioni i së Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit, bazuar në fushëveprimin e kompetencave të tij, më datë 30 shtator 2022 lëshon këtë:

4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË  
Kërkesa për opinionin ligjor me *acquis* të BE-së është dërguar në kopje fizike më datën 30.09.2022 me numër të referencës 2314.

#### 5. HYRJE

Qëllimi i këtij *Projektligji* është të krijojë një mekanizëm për kompensimin deri në një masë të caktuar të rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore dhe punëve përcjellëse në kontratat për punë të lidhura në mes të Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomikë konform Ligjit përkatës për Prokurim Publik.<sup>3</sup> Ky projektligj përmban gjithësej 12 nene.

#### 6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT AKTIT

Zbatimi i parimeve të tregut të brendshëm të BE-së siguron shpërndarje më të mirë të burimeve ekonomike dhe përdorim më racional të fondeve publike për produkte dhe shërbime të cilësisë më të lartë të disponueshme me çmimin më të mirë nën një konkurrencë të drejtë. *Acquis* e BE-së përcakton rregulla për fushëveprimin e konkurrencës së lirë dhe prokurimit publik në tregun e brendshëm të BE-së. Baza ligjore e legjislacionit primar të BE-së për fushën e prokurimit publik përfshinë nenet 26, 34, 53(1), 56, 57, 62 dhe 114 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).<sup>4</sup> Ndërsa nenet 101 deri në 109 të TFBE) përmbajnë rregulla për konkurrencën në tregun e brendshëm, duke ndaluar marrëveshjet kundër konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve. Operatorët ekonomik me pozitë dominuese në treg nuk duhet të abuzojnë me pozicionin e tyre në një mënyrë që ndikon negativisht në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare. Rregullat e konkurrencës zbatohen gjithashtu për ndërmarrjet publike, shërbimet publike dhe shërbimet me interes të përgjithshëm.<sup>5</sup>

#### 7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA MINISTRIA E LINJËS

##### I. Në aspektin përmbajtësor dhe ligjor.

Duke ju referuar pikës 6 të këtij Opinioni ligjor, në kuadër të BE-së ekzistojnë parime dhe rregulla për konkurrencën dhe tregun e brendshëm. Përgjatë nxjerrjes së legjislacionit sekondar dhe zbatimit të *Projektligjit për Mbështetjen e Punëve Publike*, të merren parasysh parimet e konkurrencës së lirë dhe prokurimit publik.

<sup>3</sup> Neni 1 i Projektligjit.

<sup>4</sup> Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, i qasshëm përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012E%2FTXT>.

<sup>5</sup> Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, i qasshëm përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012E%2FTXT>.

## II. Në aspektin teknik

Të gjitha dokumentet e tjera janë dërguar dhe plotësuar sipas Manualit për Plotësimin e Tablave të Përputhshmërisë dhe Deklaratës së Përputhshmërisë<sup>6</sup>. Rekomandohet që të përdoret njëtrajtshëm emri i Projektligjit, pasi që është përdorur në dy forma të ndryshme brenda Projektligjit dhe kërkesës për Opinion Ligjor të Përputhshmërisë.

## 8. OPINIONI PËR PËRPUTHSHMËRINË

Ky opinion për përputhshmërinë me *acquis* është bazuar në përmbajtjen e projektligjit. Përgjegjësia e Divizionit të së Drejtës së BE-së vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa organi propozues, është përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP) atëherë kur Projekt-akti ndërlidhet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesërishtëm deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projektligjit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës.

## 9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Parime e tregut të brendshëm të BE-së përfshijnë konkurrencën e lirë dhe prokurimit publik për ndërmarrjet publike, shërbimet publike dhe shërbimet me interes të përgjithshëm. Fushëveprimi i konkurrencës së lirë dhe prokurimit publik për ndërmarrjet publike në nivel të Kosovës transpozojnë *acquis* të BE-së.<sup>7</sup> Përgjatë nxjerrjes së legjislacionit sekondar dhe zbatimit të *Projektligjit për Mbështetjen e Punëve Publike*, të merren parasysh parimet e konkurrencës së lirë dhe prokurimit publik.

Me respekt,

Labinote Kashtanjeva

Zv. Udhëheqëse e Divizionit për

Çështje Ligjore të BE-së

Divizioni për të Drejtën e BE-së

Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit

<sup>6</sup> E qasshme në: <http://mei-ks.net/sq/dokumente-udhzuese-mbi-procesin-e-prafrimit-ligjor>

<sup>7</sup> *Shih* Neni 1 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Data e publikimit: 07.06.2022, Gazeta Zyrtare: 14/2022, i qasshëm përmes: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=59498>. *Shih gjithashtu*, Neni 1 i Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Data e publikimit: 19.09.2011, Gazeta Zyrtare: 18/2011, i qasshëm përmes: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>., i plotësuar dhe ndryshuar nga Ligji Nr. 04/L-237, Ligji Nr. 05/L-068, dhe Ligji Nr. 05/L-092.